



VENDIM

Nr. 160, Datë 06.10.2016

**MBI
PËRJASHTIMIN E KLIENTËVE FUNDORË QË FURNIZOHEN
NGA SHËRBIMI UNIVERSAL NGA PËRGJEGJËSIA PËR
DISBALANCAT**

Në mbështetje të neneve 16; 81 pika 2 dhe 109 të Ligjit nr. 43/2015, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, *VKM nr. 244, datë 31.04.2016 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrjnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike” dhe nenit 26 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin Nr 96 date 17.06.2016 të Bordit të ERE, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 06.10.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorive Teknike në lidhje me perjashtimin e Klientëve fundorë që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal nga përgjegjësia për disbalancat kundrejt këtij të fundit,*

Konstatoi se:

- Ligji nr. 43/2015 “Për Sektorin e energjisë elektrike” në pikën 2 të nenit 81 pika 2, sjell një nga rrethanat perjashtimore, sa i përket trajtimit të disbalancave duke parashikuar se: *ERE vendos perjashtimin nga përgjegjësia për disbalancat, për kategori të caktuara të klientëve fundorë, të cilët furnizohen mbi bazën e shërbimit universal të furnizimit, si detyrim i shërbimit publik.*

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të miratojë perjashtimin nga përgjegjësia për disbalancat për Klientët fundorë që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal, në kuptim të nenit 109 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë OSHEE sh.a, KESH sh.a, OST sh.a dhe Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë për vendimin e Bordit të ERE.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI